VENDIM
Nr. 72, datë 14.2.2024

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 1 TË MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR PROJEKTIN "SHTRATI I LUMIT LANA – ZHVILLIMI URBAN", RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 64/2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin "Shtrati i lumit Lana – zhvillimi urban", ratifikuar me ligjin nr. 64/2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

[Letra me kokë e BEI-t]

ME KORRIER
Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ("Përfituesi")
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 3, Republika e Shqipërisë
Në vëmendje të: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
Email: sekretariamin@finance.gov.al

Luksemburg, 20 november 2023 *JU/OPS-[POL/OEU-B/SB/ng/2023-15566*

Lënda: SHTRATI I LUMIT LANA – RIZHVILLIMI URBAN

Numri i veprimit (Serapis N°): 2016-1020; Numri i kontratës (Fl N°): 91307
Marrëveshje Granti ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve ("Banka") dhe Përfituesit, datë 5 korrik 2019, me kontratën numër 91307 ("Marrëveshja e Grantit")

Marrëveshje Ndryshuese N°1
Të nderuar zotërinj,
I referohemi Marrëveshjes së Grantit.
PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI
Në këtë Marrëveshje Ndryshuese ("Marrëveshje Ndryshuese"):
"Datë e hyrjes në fuqi" nënkupton:
datën kur Banka konfirmon (duke përfshirë me postë elektronike ose mjete të tjera elektronike) ndaj Përfituesit se Banka ka marrë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të:
a) 2 (dy) origjinale të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, në format të printuar, në përputhje me dispozitat e nenit 4 (Shkëmbimi i Origjinaleve) të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, të nënshkruar sipas rregullave nga Përfituesi; dhe
b) konfirmimin me shkrim të Përfituesit për përfundimin e procedurave të tij të brendshme që kërkohen për ta bërë këtë Marrëveshje Ndryshuese efektive.

Me përjashtim të rasteve kur konteksti kërkon ndryshe ose nëse përcaktohet ndryshe, termat e përkufizuara në Marrëveshjen e Grantit dhe shprehjet e përdorura në të kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë Marrëveshje Ndryshuese.

Me efekt nga Data e Hyrjes në Fuqi, çdo referencë në Marrëveshjen e Grantit ndaj "kësaj Marrëveshjeje" (ose referenca të tjera të ngjashme) lexohet dhe interpretohet si një referencë ndaj Marrëveshjes së Grantit, të ndryshuar nga kjo Marrëveshje Ndryshuese.

NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN E GRANTIT

Me efekt nga Data e Hyrjes në Fuqi, Marrëveshja e Grantit ndryshohet siç përcaktohet më poshtë:

a) Pika "i", në nenin 2(2) të Marrëveshjes së Grantit zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm dhe, sipas rrethanave, Data e Përfundimit duhet të zgjatet deri në datën 31 dhjetor 2026:

"i) 31 dhjetor 2026 ("Data e Përfundimit") ose...";

b) Paragrafi *"Për Bankën"* me të dhënat e Bankës për njoftimet në nenin 18(3) të Marrëveshjes së Grantit, zëvendësohet me të dhënat e mëposhtme:

"Për Bankën: *Në vëmendje të: GLO/-/ENL*
100 boulevard "Konrad Adenauer" L-2950
Luxembourg
Faksimile nr.: +352 4379 58417
Adresa e email-it: glo_enl@eib.org".

TË NDRYSHME

Dispozitat e Marrëveshjes së Grantit, me përjashtim të ndryshimeve në këtë Marrëveshje Ndryshuese, do të vazhdojnë në fuqi dhe efekt të plotë. Kjo Marrëveshje Ndryshuese nuk është (dhe nuk do të konsiderohet të jetë) një pëlqim, marrëveshje, ndryshim ose heqje dorë në lidhje me ndonjë term, dispozitë ose kusht të Marrëveshjes së Grantit, përveç siç është rënë dakord shprehimisht në të. Banka rezervon çdo të drejtë ose mjet tjetër ligjor që mund të ketë aktualisht ose më pas.

Me kërkesë të Bankës dhe me shpenzimet e veta, Huamarrësi kryen të gjitha veprimet dhe hapat e nevojshëm ose të dëshirueshëm për të vënë në zbatim ndryshimet e kryera ose që do të kryhen në përputhje me këtë Marrëveshje Ndryshuese.

Përfituesi i vërteton Bankës se të gjitha përfaqësimet dhe garancitë që do të bëhen nga Përfituesi diku tjetër në Marrëveshjen e Grantit, janë të vërteta në të gjitha aspektet në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese nga Përfituesi dhe në Datën e Hyrjes në fuqi.

Dispozitat e nenit 17 (Ligji Rregullues dhe juridiksioni) të Marrëveshjes së Grantit do të përfshihen në këtë Marrëveshje Ndryshuese, sikur të përcaktoheshin plotësisht në këtë Marrëveshje Ndryshuese dhe sikur referencat në këto klauzola ndaj "kësaj Marrëveshjeje" janë referenca ndaj kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese.

SHKËMBIMI I ORIGJINALEVE

Nëse jeni dakord me sa më lart, ju lutem kthejini Bankës, me postë të regjistruar ose korrier, 2 (dy) origjinale bashkëlidhur, në format të printuar, të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, të shënuar në vëmendje të z. Alessandro Cagnato, Departamenti Juridik, i sigluar në çdo faqe, me datë dhe të nënshkruar sipas rregullave në emër dhe për llogari të Përfituesit.

Me respekt,
BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

Matteo Rivellini	**Anne-France Catoir**
DREJTUES DIVIZIONI	KËSHILLTAR LIGJOR

Rënë dakord dhe pranuar për dhe në emër të:
Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë
në cilësinë e Përfituesit
Emri: Ervin Mete
Pozicioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Data: 13.12.2023